



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË SUHAREKËS PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkohet falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës

Adresa: Rr. Brigada 123 Suharekë, 23000, Suharekë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Suharekës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës (KS), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Suharekës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Suharekës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të KS kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

- 1 Komuna si rezultat i planifikimit jo të duhur të buxhetit nga kategoria e investimeve kapitale ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 227,653€ të cilat për nga natyra dhe përmbajtja i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime (98,000€ ishin për mirëmbajtje dimërore të rrugëve lokale dhe 129,653€ për mirëmbajtje dhe pastrim të qytetit). Po ashtu, nga kategoria e subvencioneve ishte kryer pagesa në vlerë prej 1,235€ në emër të pagave.

Duke qenë se çështja në fjalë është mjaft e përhapur në shumë organizata buxhetore dhe po përsëritet për vite me radhë, ajo do të trajtohet më hollësisht në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Suharekës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Suharekës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Suharekës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Suharekës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Suharekës.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Suharekës në vitin 2020 ishin në vlerë 1,503,448€. Ato kanë të bëjnë me: të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja, taksa për matjen e tokës.

Çështja A1 - Zbritja primare në më shumë se një pronë rezidenciale tek tatimpaguesit

Gjetja Sipas nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme, zbritja për vendbanim primar paragrafi 4 - Personi fizik i cili ka në pronësi apo posedim dy (2) ose më shumë njësi rezidenciale të objekteve, mund të deklarojë në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, vetëm një prej këtyre objekteve si vendbanimin e tij parësor, pa marrë parasysh faktin që njësitë e objekteve mund të ndodhen në komuna të ndryshme.

Komuna ka zbatuar zbritjen primare ndaj 109 tatimpaguesve[1] të cilët kanë në posedim prona rezidenciale më shumë se një pronë. Dëmi financiar i shkaktuar komunës si rezultat i faturimit të pasaktë është 2,542€.

Kjo gjendje ka ndodhur për shkak të mos konfigurimit të sistemit të kontrollit në softuerin protax të cilin e përdor komuna për tatimin në pronë.

Ndikimi Llogaritja e pasaktë e faturës duke zbatuar zbritjen përveç pronës primare edhe për pronat tjera dëmton buxhetin e komunës dhe shkakton pakënaqësi tek tatimpaguesit.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të siguroj se, në bashkëpunim me mirëmbajtësit e softuerit të Pro-tax-it ndërmerren masa në rregullimin e të dhënave në mënyrë që faturimi të jetë i saktë dhe të korrighohen faturat e lëshuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 2,338,089€, prej tyre ishin shpenzuar 1,913,097€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me: Shërbime të ndryshme shëndetësore, shërbime kontraktuese tjera, furnizim me derivate, mirëmbajtje dhe riparime, furnizim për zyre etj. Kemi testuar 7 mostra për teste substanciale në vlerë 120,269€ si dhe 5 mostra për procedura të pajtueshmërisë.

Çështja A2 - Mos konfiskimi i sigurimit të tenderit

Gjetja Sipas nenit 57 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik - Sigurimi i tenderit- Siguria e tenderit që është depozituar nga tenderuesi do të konfiskohet, në rast se tenderuesit në fjalë i është dhënë kontrata përkatëse në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi pastaj refuzon ose dështon: (ii) që të përmbushë çfarëdo kushti tjetër që ishte specifikuar në dosjen e tenderit, para nënshkrimit të kontratës përkatëse.

Në procedurën e prokurimit “Instalimi dhe Sanimi i ndriçimeve publike”, komisioni i vlerësimit të ofertave dhe menaxheri i zyrës së prokurimit kanë vendosur të shpërblejnë me kontratë operatorin ekonomik me ofertën në vlerë prej 158,204€ (oferta më e ulët). Në kërkesën e Komunës drejtuar OE për dorëzimin e dëshmimeve të kërkuara në pikën 6.4 (kërkesat e përshtatshmërisë) të dosjes së tenderit respektivisht vërtetimi nga ATK, vërtetimi nga gjykata dhe vërtetimit të tatimit në pronë, OE nuk i është përgjigjur dhe për këtë arsye është eliminuar. Komuna ka vazhduar me procedurën e tenderimit duke mos konfiskuar sigurinë e tenderit në vlerë prej 2,500€, ndërsa ka shpallur fitues operatorin e dytë me radhë, në shumë prej 188,341€.

Komuna nuk ka ndërmarrë hapat e nevojshëm sipas pikës 8 të nenit 57 të LPP-së e që do duhej të njoftojë OE për konfiskimin e sigurisë së tenderit. Kjo ka ndodhur për shkak të situatës pandemike vështirësive financiare për operim normal të bizneseve ofertuese.

Ndikimi Mosveprimi për konfiskimin e sigurisë së tenderit shkakton dëmtim buxheti për vlerën e pa inkasuar. Mos aplikimi i masës ligjore, ofron mundësin e pjesëmarrësve jo serioz dhe të pa përgjegjshëm në tender, që rezulton edhe me kosto jo ekonomike për komunën.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se do të aplikohet konfiskimi i sigurisë së tenderit në rastet kur operatorët ekonomik tërhiqen apo nuk përgjigjen për të plotësuar kërkesën mbi përshtatshmërinë. Konfiskimi i sigurisë së tenderit për ofertuesit e papërgjegjshëm zvogëlon mundësin e pjesëmarrjes së ofertuesve joserioz.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 471,281€, prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 457,828€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me: Subvencionimin e entiteteve publike dhe jopublike. Kemi testuar 10 mostra për teste substanciale në vlerë 17,748€ si dhe 5 mostra për procedura të pajtueshmërisë.

Çështja B1 - Dobësi në subvencionimin e OJQ-vë

Gjetja

Në fushën e subvencioneve dhe transfere shpалosim gjetjet si në vijim:

Rregullore MF-nr. 04/2017 mbi Kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve - Kapitulli II - Neni 6 - Plani vjetor i mbështetjes financiare, paragrafi 1 specifikon: Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

- Komuna nuk kishte përgatitur planin vjetor të financimit, respektivisht të subvencionimit të OJQ-ve, të njëjtin do të duhej ta dorëzonte në zyrën për qeverisje të mirë pranë zyrë së kryeministrit.

Kjo ka ndodhur për shkak të kujdesit jo të duhur dhe volumit të punëve nga zyrtarët përkatës.

Sipas të njëjtës rregullore Kapitulli II - Neni 7 - Kapacitetet institucionale pika 4 - Ofruesi i mbështetjes financiare duhet të emërojë zyrtarin përgjegjës apo të themelojë ekip të veçantë për secilën kontratë të lidhur me OJQ-të përfituese, me qëllim të monitorimit të zbatimit të projektit/programit si dhe vlerësimit të përmbushjes së objektivave dhe arritjes së rezultateve të parapara[*]. Ndërsa pika 3. Ofruesi i mbështetjes financiare duhet të themelojë Komisionin e Ankesave, i cili do të merret me trajtimin e ankesave eventuale të aplikantëve[*].

- Komuna nuk kishte emëruar zyrtar apo ekip për monitorimin e realizimit të projektit të financuar nga vet komuna që realizohet nga OJQ[*], si dhe nuk kishte formuar komision për shqyrtimin e ankesave siç kërkohet në nenet e rregullores së MF.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos familjarizimit të duhur me rregulloren nga zyrtarët përkatës, respektivisht të mosnjohjes së duhur të kërkesave të rregullores.

Ndikimi Financimi i OJQ-ve pa plan mund të ketë për pasojë financimin e projekteve me më pak prioritet, e si rrjedhojë ndikon që të mbeten pa u realizuar projektet me prioritet dhe me rëndësi më të madhe për publikun. Mos emërimi i monitoruesit të realizimit të projektit të financuar, ndikon potencialisht në mosrealizim të tij, në formën, kohën, mënyrën dhe cilësinë e paraparë. Po ashtu, mos emërimi i komisionit të ankesave ka ndikuar në imazhin jo të mire të Komunës për shkak të mosbesimit të publikut, dhe zvogëlon transparencën e procesit.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë se është përgatitë plani vjetor i financimit të OJQ-ve, duke ju dhënë prioritet projekteve me rëndësi për publikun e gjerë, njëherit të siguroj që plani vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve dërgohet në zyrën përkatëse të qeverisë duke respektuar kriteret e përcaktuara me rregullore. Gjithashtu, duhet të formoj komisionet përkatëse për monitorimin e subvencioneve dhe për shqyrtimin e ankesave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 6,633,125€, prej tyre ishin shpenzuar 5,785,548€. Ato kanë të bëjnë me: ndërtimin e rrugëve lokale, objekteve të ndryshme në arsim, kulturë dhe sport, shpronësimin e tokave për projekte të ndryshme investive etj. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 1,845,363€ si dhe 5 mostra për procedura të pajtueshmërisë.

Çështja A3 - Parregullsi në planifikimin e kërkesave dhe menaxhimin e kontratës

Gjetja Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik si dhe Rregullat dhe udhëzuesi për prokurimin publik, përcaktojnë kriteret për menaxhimin e kontratës. Sipas pikës 61.19 (b) të RRUOPP një nder përgjegjësit e menaxherit të projektit do duhet të “sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë”.

Gjatë ekzaminimit fizik të punëve në teren të projektit “Ndërtimi i urave në komunë – Leshan, Reshtan, Studenqan –Tërnje, Suharekë (Mulliri i Beqës)”, në vlerë prej 134,914€, kemi vërejtur që ishin pranuar dhe paguar punë të cilat nuk ishin realizuar. Kemi identifikuar se pozicioni i ofertës financiare sipas kontratës 1.6.1 (Furnizimi, transporti, punimi, vendosja dhe ngjyrosja e rrethojës, parmakëve të urës sipas standardeve me profile, tuba të çeliktë S275) i përcaktuar në total për katër ura me vlerë 5,740€ (si sasi 4,592kg) nuk ishte realizuar në tersi sepse në njërin nga urat (te

Mulliri i Beqës në Suharekë) nuk ishin të vendosura përmakët. Ndonëse sipas raportit përfundimtarë të menaxherit të projektit dhe organit mbikëqyrës dt.12.11.2020 të gjitha pozicionet janë përfunduar dhe pranuar sipas kontratës dhe është paguar situacioni i pestë, si pagesë përfundimtare.

Dobësitë e identifikuara kanë ndodhur si rezultat i mungesës së kontrollit në planifikimin fillestarë me paramasë dhe parallogari nga njësia kërkuese (ku përmakët janë vendosur në kilogram dhe vlerë të cilat gabimisht ishin llogaritur vetëm për tri ura) dhe menaxhimit jo të mirë të kontratës respektivisht pranimit të punimeve nga komisioni mbikëqyrës ku nuk ishte precizuar se njësit janë harxhuar dhe një urë ka mbetur pa u përfunduar.

Ndikimi Dobësitë me rastin e pranimit të punëve jo në përputhje me kontratën nga komisioni i pranimit dhe menaxheri i kontratës rezultojnë me pagesa të parregullta për punët të cilat nuk janë kryer sipas kontratës dhe dëmton buxhetin e Komunës.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë se komisionet e pranimit dhe menaxherët e kontratave aplikojnë kontrole efektive me rastin e pranimit të punëve/furnizimeve dhe se pagesat bëhen vetëm për punët/furnizimet e realizuara në përputhje me kontratën.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.5 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 284,085,153€, pasurive jokapitale është 2,223,376€, si dhe e stoqeve 58,610€. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 48,725,560€, si dhe 70 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja C1 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja Neni 6 i rregullores për Menaxhimin e pasurisë jo financiare nr.023/2013 përcakton që: “Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnojë regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Sipas nenit 22 pika 1 - zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtvizore. Sipas nenit 18 pika 3 - Organizatat buxhetore duhet të kontrollojnë së paku njëherë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë jo financiare dhe një aktivitet tjetër që i paraprinë inventarizimit është se komuna duhet nxjerrë udhëzime të brendshme sipas nenit 19 pika 5. Pasuritë duhet të vlerësohen duke marrë parasysh zhvlerësimin që është grumbulluar nga momenti i blerjes së pasurisë. Nga testimet tona konstatuam si në vijim:

- Kryetari ka emëruar komisionin e inventarizimit në QKMF[*] me dt.18.11.2020 i cili nuk ka arritur të kryej inventarizimin e pasurisë jo financiare për vitin 2020;
- Krahasuar me vitin e kaluar Komuna ka avancuar në regjistrimin e pasurisë jo kapitale nën 1,000€. Mirëpo prapë kemi identifikuar se pasuria e evidentuar në regjistrin e brendshëm të QKMF dhe asaj të regjistruar në softuerin e-pasuria nuk përputhet në vlerë prej 147,040€ (si pajisje-karrige, monitorë etj.). Kjo vlerë e pasurisë ka mbetë e paregjistruar në regjistrin e-pasuria dhe nuk është prezantuar në PFV; dhe
- Për pasurinë nën 1,000€ nuk është bërë përlogaritja e shpenzimeve të zhvlerësimit për vitin 2020, dhe zhvlerësimi i akumuluar nuk është i plotë për shkak të mosfunksionimit të softuerit e-pasuria.

Mangësitë e identifikuara janë rezultat i kujdesit jo të duhur të komisionit të inventarizimit, pastaj regjistrimi jo i plotë i pasurisë ka ndodhur për shkak të mos kompetencës së zyrtarit përkatës që regjistron pasurinë sepse ai nuk ka ndjekur trajnimet lidhur me softuerin e-pasuria. Po ashtu, zhvlerësimi nuk është llogaritur për shkak të mirëmbajtjes së dobët të softuerit e-pasuria. Komuna ka kontaktuar mirëmbajtësit e sistemit por pa ndonjë rezultat pasi sistemi mirëmbahet nga MAP.

Ndikimi

Mos përgatitja e raportit të inventarizimit, regjistrimi jo i plotë i pasurisë në softver dhe mos aplikim i zhvlerësimit të asetëve nën 1,000€, ndikon që prezantimi i pasurisë në regjistrat e Komunës dhe PFV të jetë i pasaktë, dhe kjo mund të rezultojë me humbjen apo përvetësimin e pasurisë në mënyrë të paligjshme.

Rekomandimi C1

Kryetari duhet të sigurojë përzgjedhjen e anëtarëve kompetentë në komisionin e inventarizimit dhe të ndërmerr masa për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e softuerit e-pasuria në mënyrë që zhvlerësimi të ndodhë me kohë. Të ofrohen trajnime për zyrtarin përkatës i cili do të regjistrojë pasurinë jokapitale në softver.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.6 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV e vitit 2020 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 5,166,839€. Kjo vlerë përbehet nga: tatimi në pronë, tatimi në tokë/palujtshmeri, taksa komunale (aktivitete), qiraja e tokës dhe objekteve publike etj.

Çështja C2 - Dobësi në menaxhimin e të arkëtueshmëve

Gjetja

Ligji nr. 06/L-005 për tatimin në pronen e Palujtshme, kapitulli VII neni 26, autoriteti dhe kompetenca për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara paragrafi 1. Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kapitulli për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove në perputhje me këtë ligj. Në kontratat e lidhura në mes të komunës dhe qiramarrësve janë paraparë masat që duhet të ndërmarrën në rast të mos pagesës së qirasë sipas kriterëve të përcaktuara në kontratë. Më tutje, në nenin 3 të kontratave, janë specifikuar të drejtata dhe obligimet e palëve.

Në kontratat e lidhura në mes të komunës dhe qiramarrësve janë paraparë masat që duhet të ndërmarrën në rast të mos pagesës së qirasë sipas kriterëve të përcaktuara në kontratë. Më tutje, në nenin 3 të kontratave, janë specifikuar të drejtat dhe obligimet e palëve duke parashikuar edhe masat, se në rast vonese për pagesën e qirasë, qiramarrësi do të ndëshkohet me kamat bankare në fuqi.

Llogaritë e arkëtueshme kanë trend të rritjes dhe komuna nuk ka ndërmarr asnjë aktivitet ligjor në inkasimin e tyre gjatë vitit 2020.

Po ashtu, komuna ka prezantuar llogarinë e arkëtueshme nga qiratë në vlerën 565,180€ për të cilinë nuk kishte arritë të ndërmarr veprime, të parashikuara në kontratë.

Komuna gjithashtu përballet edhe me vlerën e lart të llogarive nga taksa në aktivitet prej 1,339,761€, me një trend rritës dhe po ashtu nuk janë ndërmarr masa për zvogëlim të kësaj llogarie.

Kjo gjendje është ndikuar dukshëm për shkak të vështirësive të bizneseve dhe qytetareve për ti realizuar obligimet ndaj komunës, si pasoj e situates pandemike.

Ndikimi

Rritja e vazhdueshme e të arkëtueshmëve ndikon në realizimin e projekteve të cilat do financoheshin nga të hyrat vetanake.

Rekomandimi C2

Kryetari i komunës duhet të forcojë kontrollin në menaxhimin e të arkëtueshmëve dhe të zbatoj mekanizmat ligjorë të mbledhjes së tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve nga kategoritë ekonomike dhe të hyrat e mbledhura. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁸	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	16,933,883.00	18,043,609.90	16,676,230.39	15,572,695.78	16,307,057.27
Grante Qeveritare Buxheti	14,963,227.00	15,211,370.78	14,891,088.43	13,656,162.74	14,176,543.54
Financimi huamarrjes përmes	0.00	158,384.70	136,679.75	38,467.27	64,900.80
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	617,891.60	456,636.46	340,091.08	526,389.45
Të hyrat vetanake	1,970,656.00	1,970,656.00	1,109,379.50	1,537,974.69	1,456,155.50
Donacionet vendore	0.00	5,760.00	3,446.25	0.00	0.00
Donacionet e jashtme	0.00	79,546.82	79,000.00	0.00	83,067.98

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është rritur për 1,109,727€. Kjo rritje është rezultat i mbështetjes financiare të Qeverisë me vendimin 11/30 si pasojë e pandemisë covid - 19 në vlerë prej 231,837€, me vendim të Qeverisë 01/27 janë ndarë mjete për arsim dhe mallra e shërbime në vlerë prej 96,886€, bartjes së mjeteve nga të hyrat vetanake në vlerë prej 617,892€ të alokuar sipas vendimit të asamblesë komunale, pjesa tjetër është rezultat i donacioneve dhe burimeve tjera të financimit.

Në vitin 2020 Komuna ka shpenzuar 92% të buxhetit final ose 16,676,230€, po thuajse njëjtë me vitin e kaluar 2019, që ishte 93%.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	16,933,883.00	18,043,609.90	16,676,230.39	15,572,695.78	16,307,057.27
Pagat dhe mëditjet	8,464,238.00	8,601,113.47	8,519,756.59	8,229,755.60	8,174,020.95
Mallrat dhe shërbimet	1,816,144.00	1,990,348.11	1,633,281.15	1,468,962.35	1,375,492.72
Komunalitë	300,000.00	347,741.44	279,816.47	273,880.55	244,472.71
Subvencionet dhe transferet	310,219.00	471,281.42	457,828.00	298,620.00	1,278,201.04
Investimet Kapitale	5,002,676.00	6,633,125.46	5,785,548.18	5,301,477.28	5,234,869.85
Rezervat	1,040,606.00	0.00	0.00	0.00	0.00

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:


- Rritja e buxhetit final të pagave dhe mëditjeve krahas buxhetit fillestar për 136,876€ është një reflektim i rekrutimit të 92 zyrtarëve, si dhe shtesave në paga me vendimin e Qeveris për menaxhimin e pandemisë.
- Rritja e buxhetit final të mallrave dhe shërbimeve si dhe komunalit për 221,945€ është rezultat i rishpërndarjes së rezervave, mbështetjes së Qeverisë dhe të hyrave të bartura.
- Rritja e buxhetit final krahas atij fillestar për subvencione dhe transfere prej 161,062€ është rezultat i rishpërndarjes së rezervave, mbështetjes së Qeverisë, të hyrave të bartura, donacioneve dhe burimeve tjera të financimit të ndara për menaxhimin e pandemisë.
- Rritja e buxhetit final për investime kapitale prej 1,630,449€ krahas buxhetit fillestar, është rezultat i rishpërndarjes së rezervës, mbështetjes së Qeverisë gjatë vitit, të hyrave vetanake, donacioneve dhe burimeve tjera të financimit. Komuna ka shpenzuar 87% të buxhetit final.

Për shkak të situatës pandemike me Covid – 19 Komuna e Suharekës kishte shpenzuar buxhet të ndarë për këtë qëllim në vlerë totale prej 441,801€, prej të cilave 269,430€ ishin shtesa në paga dhe mëditje, 36,311€ për mallra dhe shërbime si dhe 136,060€ subvencione dhe transfere.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Komuna e Suharekës kishte realizuar të hyra në vlerë 1,503,448€, apo 76% krahasuar me planifikimin e vitit 2020. Ndërsa krahasuar me vitin paraprak realizimi i të hyrave ka pësuar rënie për 13%.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	1,970,656.00	1,970,656.00	1,503,447.91	1,738,347.84	1,581,632.68
Të hyrat tatimore	923,229.00	923,229.00	681,365.48	766,843.00	685,035.20
Të hyrat jo tatimore	1,047,427.00	1,047,427.00	822,082.43	971,504.84	896,597.48

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të Komunës së Suharekës ka rezultuar në dhjetë rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, gjashtë rekomandime janë zbatuar, dy ishin në proces, një nuk është i aplikueshëm dhe një nuk është zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 4, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve). (Vëni re se kur ceket fundi i auditimit, i referohemi fundit të procesit të auditimit – deri në momentin kur e dërgojmë raportin e këtij viti).

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave komunale do të bëhet ashtu siç parashihet me ligj duke bërë verifikimin e pronave së paku 20 % në vit, për të reflektuar gjendjen reale të pronave të tatuara, që rezulton me të hyra të sakta komunale si dhe performancë më të mirë buxhetore.	Marr përsysh situatën pandemike Komuna ka bërë verifikimin e një pjese të pronave.	I zbatuar
2.	Të hyrat	Kryetari i komunës duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e pronave të paluajtshme të dhëna në shfrytëzim, si dhe të sigurojë që çdo pronë të ngarkohet me taksë, në përputhje me kushtet dhe hapësirën shfrytëzuese të pronës komunale.	Janë ndërmarr veprime të mjaftueshme.	I zbatuar
3.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitetë	Kryetari duhet të sigurojë që komisionet përkatëse për pranimin e shërbimeve apo furnizimeve janë caktuar me kohë, pranimi i mallrave/shërbimeve është bërë sipas rregullave të përcaktuara dhe që pagesat bëhen bazuar në raportet e pranimin.	Janë ndërmarr veprime dhe nuk janë detektuar raste të reja.	I zbatuar
4.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj që plani dhe raporti vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve dërgohen në zyrën përkatëse të qeverisë duke respektuar kriteret e përcaktuara në ligj.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të ndërmerr masat për forcimin e kontrolleve lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve sipas planit dinamik dhe kushteve të kontratës, si dhe zgjidhjen e çështjeve pronësore dhe administrative para fillimit të punimeve, në mënyrë që mos të ketë ndërprerje të punimeve dhe projektet të realizohen sipas planit dinamik. Njëherit për projekte që janë në vonesa të realizimit të sigurohet se është kërkuar vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit.	Janë ndërmarr veprime të mjaftueshme.	I zbatuar
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se plani i prokurimit është hartuar pas një analize të hollësishme të të gjitha njësive kërkuese dhe ka përfshirë sipas prioriteteve të gjitha projektet e planifikuara. Njëherit kur paraqiten nevoja për blerje jashtë planit duhet të vendosen mekanizma për njoftim paraprak të organeve relevante sipas kërkesave ligjore.	Janë ndërmarr veprime të mjaftueshme.	I zbatuar

7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo ridestinim të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate	Kjo çështje do të trajtohet në Raportin vjetor të auditimit RVA.	Nuk është i aplikueshëm më
8.	Pasuritë	Kryetari, duhet të ndërmerr masa për të siguruar se pasuritë mbi dhe nën 1,000€ janë regjistruar në regjistrat përkatës, për të gjitha pasuritë që ka në posedim në mënyrë që prezantimi i informatave në PFV të jetë i saktë dhe i plotë. Njëherit duhet të siguroj që raporti i inventarizimit merret në konsideratë para përgatitjes së PFV.	Janë ndërmarr veprime por të pjesërisht dhe ende është në proces zbatimi i rekomandimit.	Pjesërisht i zbatuar
9.	Llogaritë arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive opsionet e mundshme për të siguruar se dhënia në shfrytëzim e pronës mbulohet me kontrata duke u bazuar në rregulla dhe ligje në fuqi. Gjithashtu, për të gjitha pronat komunale të dhëna në shfrytëzim, komuna duhet të pranoj pagesën/qiranë e dakorduar bazuar në kontrata apo marrëveshje valide.	Janë ndërmarrë veprime të pjesshme.	Pjesërisht i zbatuar
10.	Obligimet papaguara	Kryetari, duhet të konsiderojë që me rastin e planifikimit të buxhetit t'i trajtojë obligimet e mbetura me Ministrinë e Financave dhe të vendosë prioritetet buxhetore në kryerjen e tyre. Po ashtu, të gjitha faturat e konfirmuara apo vendimeve tjera për shpenzime, t'i kryejë me kohë sipas afatit të paraparë ligjor prej 30 ditëve.	Auditori nuk ka identifikuar raste të ngjashme.	i zbatuar

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se, në bashkëpunim me mirëmbajtësit e softuerit të Pro-tax-it ndërmerren masa në rregullimin e të dhënave në mënyrë që faturimi të jetë i saktë dhe të korrigjohen faturat e lëshuara.
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se do të aplikohet konfiskimi i sigurisë së tenderit në rastet kur operatorët ekonomik tërhiqen apo nuk përgjigjen për të plotësuar kërkesën mbi përshtatshmërinë. Konfiskimi i sigurisë së tenderit për ofertuesit e papërgjegjshëm zvogëlon mundësin e pjesëmarrjes së ofertuesve joserioz.
3.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se është përgatitë plani vjetor i financimit të OJQ-ve, duke ju dhënë prioritet projekteve me rëndësi për publikun e gjerë, njëherit të siguroj që plani vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve dërgohet në zyrën përkatëse të qeverisë duke respektuar kriteret e përcaktuara me rregullore. Gjithashtu, duhet të formoj komisionet përkatëse për monitorimin e subvencioneve dhe për shqyrtimin e ankesave.
4.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se komisionet e pranimit dhe menaxherët e kontratave aplikojnë kontrole efektive me rastin e pranimit të

		punëve/furnizimeve dhe se pagesat bëhen vetëm për punët/furnizimet e realizuara në përputhje me kontratën.
5.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj përzgjedhjen e anëtarëve kompetent në komisionin e inventarizimit dhe të ndërmerr masa për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e softuerit e-pasuria në mënyrë që zhvlerësimi të ndodhë me kohë. Të ofrohen trajnime për zyrtarin përkatës i cili do të regjistroj pasurinë jokapitale në softver.
6.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari i komunës duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e të arkëtueshmëve dhe të zbatoj mekanizmat ligjorë të mbledhjes së tyre.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Emine Fazliu, Ndhmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Luljeta Morina, Udhëheqëse e Auditimit



Muhamet Balaj, Udhëheqës i ekipit




Ejup Simnica, Anëtar i ekipit



Mexhit Ferati, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

05-07-2021

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKAN KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
DEB GUAR - DOSTAVLJENO - SENT			
No. Br. No.	Datum Date	Gena Redite No	Adresa Adresa
01	05/07/2021	[Signature]	[Signature]

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Suharekës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020, "Raporti i auditimit të pasqyrave financiare të Komunës së Suharekës".
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Bali MUHARREMAJ

Kryetar i Komunës së Suharekës

Data: 05/07/2021, Suharekë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁹ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.¹⁰ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. Opinioni mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit (eve) material (e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Bëhet fjalë për 222 prona në emrin e 109 tatimpaguesve.
- ⁶ Dhe pika 5, Kapitulli VI- metodologjia e monitorimit dhe raportimit, Neni 23 pikat 1 dhe 2; Neni 24 dhe 25. Dhe neni 9 komisioni i ankesave pika 1,2,3,4,5. Janë katër raste në vlerë prej 10,000€ kryesisht subvencionim i sportit, (klubeve të volejbollit, basketbollit) dhe një për zhvillim kulturor.
- ⁷ Në PFV, LLA e prezantuar për vitin 2018 ishin në vlerë prej 4,331,583€, për vitin 2019 ishin 4,674,508€.
- ⁸ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁹ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹⁰ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.